



BROSHURE INFORMATIVE

**PER JU QE DESHIRONI TE STUDIONI E GJERMANI
APO QE DESHIRONI TE PERVETESONI GJUHEN
GJERMANE NE GJERMANI**



Ne e realizuam enderren tone... Po ti?

Mos e humb mundesine, informormohu dhe apliko!

Permbledhje informative

Qe prej Marsit te vitit 2004 organizata humanitare German Humanitarian Assistance e.V. mori persiper te ndihmoje dhe ti asistojte studenteve shqiptare qe jane te interesuar te mesojne gjuhen gjermane si edhe te kryejne studimet universitare e pasuniversitare apo kurse te tjera kualifikimi te gjuhes Gjermane ne Gjermani. Nepermjet programit “Asnje femije nuk eshte lene pas dore” (“No child left behind”) prioritet i jepet mbeshtetjes se studenteve Shqiptare qe kane perfunduar me sukses gjimnazin (“Shkollen e Mesme te Pergjithshme”) dhe deshirojne te studojne ne cdo universitet te Gjermanise, ne cdo dege qe i intereson. Te interesuarit jane te mikpritur te gjejne tek ne cdo lloj informacioni e mbeshtetjeje pe te kryer te tera procedurat burokratike te nevojshme. Ky program mundesohet nen mbeshtetjen e International Humanitarian Assistance (IHA) e cila eshte nje organizate humanitare jofitimprurese qe ofron sherbimin e saj ne fushen e arsimit, shendetit, te drejtave te njeriut etj. prej shume vitesh. Per nje periudhe 7 vjecare IHA ka implementuar me sukses programe te ndryshme ne fushen e arsimit, shendetesise, te drejtat e njeriut, zhvillimit te komunitetit etj. ne te 36 rrethet e Shqiperise.



Nepermjet programit “Asnje femije nuk eshte lene pas dore”, German Humanitarian Assistance e.V. merr persiper te organizoje gjithcka ne lidhje me studimin tuaj. Ju nuk duhet te preokupoheni per asgje pasi ne ju ndihmojme qe te siguronikomodimin, sigurimet shendetesore, llogarine bankare falas ne nje banke Gjermane, ju ndihmojme ne Zyren Regjistrimit ne Gjermani, ne Zyren per te Huajt etj., gjithashtu do ju informojme dhe do ju ndihmojme ne kompletimin dhe pergatitjen sic nevojitet te dokumentave te kerkuara nga ambasada Gjermane per t’ju pajisur me vize. Ne paketen e sherbimeve qe ne ofrojme perfshihet prezantimi dhe informimi mbi kulturen dhe jeten sociale ne Gjermani si dhe asistence ne zgjedhjen e Studienkolleg dhe/ose universitetit ku ju do studioni sipas deges se preferuar nga ju (nese juve ju intereson te studioni me tej ne Gjermani pas perfundimit te kursit parapergatitor te gjuhes gjermane). German Humanitarian Assistance e.V. do ju ndihmoje te pergatitini dokumentat e aplikimit ne Universitetet e zgjedhura nga ju dhe do ju informoje saktesisht per afatet e aplikimit ne keto universitete, dokumentat e kerkuara etj. Kursi i gjuhes Gjermane apo kursi parapergatitor per Studienkolleg/Universitet kryhet prane institutit IIK (Institut für Interkulturelle und Kommunikation).

Pasi te mberrini ne Gjermani ju do perballoheni me nje sere formalitetesh te tjera burokratike, mbi te cilat German Humanitarian Assistance e.V do ju informoje menjehere pas regjistrimit tuaj ne kursin e gjuhes gjermane. German Humanitarian Assistance e.V. do ju vere ne dispozicion nje pakete informative ku perfshihet lista e dokumentave dhe formaliteteve te detyrueshme dhe vendndodhja e zyrave perkatese. Perfaqesuesit tone mund edhe t’ju shoqerojne ne keto zyra ne rast se nevojitet dhe do ju asistojne ne plotesimin e formulareve te kerkuar.

Perfaqesia e shtetit Gjerman ne Shqiperi (Ambasada Gjermane ne Tirane dhe DAAD) jane te informuar per cdo hap te ketij programi dhe njoftohen menjehere per ndryshimet e herepashereshme te tij.

Ky material informativ dhe dokumenta te tjera shoqeruese jane vene ne dispozicion te instancave perkatese ne Gjermani apo Shqiperi te cilat konfirmojne qendrueshmerine e tij.

Njohurite tuaja te gjuhes Gjermane

Qe te kryesh studimet universitare ne Gjermani kerkohet te kesh njohuri te mjaftueshme te gjuhes Gjermane ne menyre qe te jesh i afte te ndjekesh leksionet dhe seminarat e lendeve perkatese dhe te japesh provime, prandaj para regjistrimit ne Universitet/Studienkolleg, studentet qe sapo kane mbaruar Shkollen e Mesme te Pergjithshme apo qe kani nisur studimin universitar ne Shqiperi, rekomandohen ndjekin kursin parapergatitor per Studienkolleg/Universitet ose te mbrojne provime te gjuhes Gjermane ekuivalente me 600 deri 1000 ore mesimore. Studentet shqiptare qe duan te studjojne ne Gjermani pas perfundimit te kursit parapergatitor per Studienkolleg/Universitet kerkohet te kene kryer rreth 400 ore mesimore te Gjermanishtes para fillimit te kursit. Te interesuarit per te ndjekur kurse te gjuhes Gjermane ne Gjermani, nuk kerkohen te kene njohuri paraprake te Gjermanishtes.

Studentet qe kane studiuar nje vit ne nje universitet te Shqiperise, i shmangen detyrimit per te ndjekur me pas Studienkolleg, por duhet te japin nje Provim Special te Gjuhe Gjermane per Studentet e Huaj qe quhet DSH i cili i lejon te regjistrohen menjehere ne Universitet.

Pse te studjoj ne Gjermani?

Diplomat e universiteteve Gjermane cilesohen me kualitetit superior dhe vleresohen shume ne mbare boten nga punedhenesit dhe institucionet akademike. Pas kryerjes se studimeve universitare meret e ashtuquajtura "Diplome" e cila ne vende te tjera si Shtetet e Bashkuara (USA) ose ne Angli konsiderohet ekuivalente me diplomen e "Master of Science" (Master ne Shkenca) ose "Master of Engineering" (Master ne Inxhinieri). Shumica e studenteve synojne te graduohen duke marre "Diplomen" e cila tregon kualifikim profesional. Ndersa "Vordiplom" ose "Para-diploma" ne Gjermani meret para Diplomes dhe konsiderohet ekuivalente me nivelin e Diplomes Uniersitare ne Shqiperi e cila ne USA ose Angli quhet "Bachelor of Science". Kualifikimi me i larte qe mund te meret ne universitetet Gjermane eshte Doktoratura, e cila eshte ekuivalente dhe e vlefshme si e tille ne cdo vend te botes.

Nje fakt tjetër i rendesishem qe ja vlen te permendet per Sistemin Universitar ne Gjermani eshte liria qe studentet kane per te organizuar studimin e tyre. Secili fakultet i ve studenteve ne dispozicion axhenden dhe planin e studimit, por rregullorja e universiteteve i lejon studentet qe te zgjedhin kurset universitare sipas deshires se tyre dhe ne kohen qe eshte me e pershtatshme per to. Kjo i lejon ato qe te planifikojne vete ne menyre individuale programin e studimit universitar sipas nevojave dhe interesave personale.

Duke u krahasuar me skemat nderkombetare, mundesia qe ju ofrohet ne Gjermani, konkuron te tere tregun apo "biznesin" e arsimit te larte. Ju lutemi ti referoheni shembujve te meposhtem:

- **Studimi ne USA** (Shemuj mbi Diplomen MBA duke perjashtuar pagesen e regjistrimit ne universitet dhe pagesen e aplikimit):

Universiteti "Golden Gate", San Francisco

\$9,540 pagesa e universitetit + \$12,700 shpenz. jeteses=\$22,240 Shpenz. totale/vit

Universiteti "Florida International", Florida

\$11,547 pagesa e universitetit + \$9,000 shpenz. jeteses = \$20,547 Shpenz. totale/vit

- **Studimi ne Angli** (Shembuj mbi Diplomen MBA duke perjashtuar pagesen e regjistrimit ne universitet dhe pagesen e aplikimit):

Universiteti "Hertfordshire", Londer

£8,500 pagesa e universitetit + £8,000 shpenz. jeteses = £16,500 Shpenz. totale/vit


Universiteti "Royal Holloway", London

£10,500 pagesa e universitetit + £9,000 shpenz. jeteses = £19,500 Shpenz. totale/vit

- **Studimi ne Gjermani** *Universitetet jane PA PAGESE per sado vite qe ju deshironi te studioni!*

0€ pagesa e universitetit + rreth 5,000€ shpenz. jeteses = 4,000-5,000€ Shpenz. totale/vit 😊

Sic e shihni, duke kryer studimet universitare ne Gjermani ju kurseni 100% te pageses per universitetin dhe mbi 50% te shpenzimeve te jeteses. Pervec kesaj ne perfundim te studimeve tuaja ju do keni pervetesuar dhe perfeksionuar nje gjuhe te huaj, gje qe eshte avantazh ne karrieren tuaj te metejshme. Ju do t'ju kushtojte vetem nje shpenzim fillestar per ndjekjen e Kursit te Gjuhes Gjermane ne Gjermani. Krahasojeni vete dhe vendosni.



Dokumentat e kerkuara, kriteret e aplikimit?

Ne menyre qe te kualifikoheni per te ndjekur nje nga kurset e gjuhes Gjermane ju lutemi te dorezoni prane German Humanitarian Assistance e.V. dokumentat e meposhtme:

1. Formularin e aplikimit prane German Humanitarian Assistance e.V. te plotesuar saktesisht.
2. Nje fotografi te vogel (pashaporte) tuajen.
3. Nje fotokopje te diplomes se shkolles se mesme te perkthyer ne gjuhen Gjermane, ose te diplomes me te fundit qe ju keni marre (universitare apo pas universitare).
4. Nje fotokopje te cdo dokumenti qe provon njohurite tuaja gjuhen Gjermane – te perkthyer ne gjuhen Gjermane). E rendesishme eshte te kryeni nje kurs te gjuhes Gjermane ne Shqiperi dhe te na vini ne dispozicion vertetimin/certifikaten qe deshmon njohurite tuaja paraprake te gjuhes Gjermane. Ne sugjerojme qe ju te keni kryer rreth 400 ore mesimore te gjuhes Gjermane para ardhjes suaj ne Gjermani. Sa me teper Gjermanisht te keni kryer ne Shqiperi aq me e favorshme eshte per ju.
5. Nje fotokopje te cdo dokumenti qe provon njohurite tuaja mbi gjuhe tjera te huaja.
6. Adresa juaj e kontaktit, numri i telefonit dhe e-mail (nese keni).

Te interesuarit per te kryer studime universitare pasi te perfundojne kursin pergatitor per Studienkolleg/Universitet jane te lutur te na kontaktojne menjehere per tu informuar mbi afatet e aplikimit ne universitet. Universitete te ndryshme kane afate te ndryshme aplikimi si edhe data te ndryshme per dhenien e provimit te pranimit ne Studienkolleg, prandaj German Humanitarian Assistance e.V. dhe IIK e pergatit programin e cdo studenti individualisht konform afateve te aplikimit ne universitet.

Ne menyre qe te kualifikoheni per te ndjekur nje nga kurset parapergatitore te gjuhes Gjermane ju duhet te:

- a) Aplikoni prane German Humanitarian Assistance e.V. te pakten 2 muaj para fillimit te kursit te gjuhes Gjermane
- b) Keni mbushur 18 vjec deri para aplikimit per vize. Te interesuarit nen 18 vjec te kontaktojne me pare perfaqesuesit e German Humanitarian Assistance e.V.
- c) Zoteroni shendet te plote qe te jeni i afte per te studiuar.
- d) Keni nje pashaporte te vlefshme deri te pakten nje vit pas aplikimit.
- e) Keni perfunduar Shkollem e Mesme te Pergjithshme dhe te jeni pajisur me "Diplome Pjekurie" nese pas kursit te gjuhes Gjermane deshironi te studioni ne universitet
- f) Jeni i lire te udhetoni dhe te jetoni i pavarur
- g) Keni burime financiare te mjaftueshme per te mbuluar shpenzimet e kursit parapergatitor per Studienkolleg/Universitet dhe shpenzimet e jeteses per periudhen e kursit.

Afati i Aplikimit

Kurset e gjuhes Gjermane mund te fillojne ne cdo kohe. Ju duhet te aplikoni te pakten 2 muaj para fillimit te kursit te deshruar. Megenese marja e vizes se gjuhes zgjat 4-6 jave, eshte e rendesishme ti filloni procedurat e aplikimit prane German Humanitarian Assistance e.V. sa me heret te jete e mundur.

Per te filluar aplikimin tuaj, mjafton te na dergoni me fax, e-mail apo poste Formularin e Aplikimit prane German Humanitarian Assistance e.V. Ky dokument mund te meret nga faqja e internetit <http://germany.ih-info.org> ose prane zyres se Programit ne Durres, Shqiperi. Perfaqesuesit e programit mund t'ju dergoje nepermjet e-mailit te tera dokumentat e kerkuara nga ju.

Pas marjes se nje pjese te dokumentave tuaja, aplikimi juaj shqyrtohet nga komisioni i programit dhe ju dergohet Aprovimi Provizor. Ne kete moment ne hapim dosjen tuaj dhe ju do te njoftoheni nga perfaqesues te German Humanitarian Assistance e.V. apo partnerit te saj lokal International Humanitarian Assistance (IHA) mbi dokumentat e mbetura per tu dorezuar, ne menyre qe dosja juaj te jete e plote. Vetem pas dorezimit te tere dokumentacionit te plote dhe pas berjes se para-pageses prej 2000€ ne njerin nga llogarit bankare te organizates, ne mund t'ju dergojme Dokumentat e Aprovimit Perfundimtar me te cilat ju mund te aplikoni per tu pajisur me vize-gjuhe.

Informacion mbi vizen tuaj

Aplikantet qe plotesojne kriteret, pajisen nga Zyra e te Huajve ne Jena me "vize per kurs gjuhe" (Sprachvisum) e cila per te interesuarit per te studiuar me tej ne Gjermani konvertohet ne "vize studenti" pasi ju te aprovoheni nga Studienkolleg i Universitetit ku do studioni. Viza qe ju do merni ne Shqiperi do jete per periudhe me te shkurter kohore sesa kohezgjatja e kursit parapergatitor qe do ndiqni ne Gjermani. Pas mberitjes ne Gjermani, perfaqesuesit e German Humanitarian Assistance e.V. do ju ndihmojne te pergatisni te tera dokumentat e kerkuara ligjerisht, nder te tjera edhe zevendesimin e vizes provizore te marre ne ambasadene Gjermane ne Tirane, me vize e cila do jete e vlefshme per tere periudhen e Kursit te Gjuhes Gjermane qe do ndiqni ne Jena-Gjermani.

Me teper informacion mbi studentet aktuale, mundesite me te fundit, foto etj gjenden ne faqen tone te internetit <http://germany.ih-info.org>

Viza e studentit meret gjithashtu ne Zyren e te Huajve te qytetit perkates ne Gjermani menjehere pas kualifikimit per studime te metejshme. German Humanitarian Assistance e.V. mund t'ju informoje mbi dokumentacionin e kerkuar dhe procedurat per marjen e vizes-studentore.

Mbani mend: Kandidatet qe kane nje vize gjermane te vlefshme e cila nuk eshte vize-gjuhe, nuk mund te aplikojne qe te kryejne kurs gjuhe apo e studiojne ne Gjermani pasi kjo vize nuk eshte e konvertueshme ne vize-gjuhe apo vize-studenti. Eshte e rendesishme qe ju te aplikoni dhe te pajiseni me llojin e sakte te vizes para ardhjes suaj ne Gjermani, ne te kundert do ju duhet te ktheheni ne Shqiperi per te aplikuar per llojin e sakte te vizes dhe vetem pasi ta merni ate mund te filloni studimin ne Gjermani.

Dokumentat e aplikimit per vize-gjuhe

Aplikimi per vize duhet te dorezohet prane Ambasades Gjermane ne Shqiperi mundesisht sa me heret te jete e mundur. Zakonisht dhenia a vizes zgjat 4-6 jave. Personeli i Ambasades do ju jape ju informacione te metejshme. Pergatitja e dokumentacionit te vizes eshte nen pergjegjesine tuaj. Ne jemi te gatshem t'ju ndihmojme dhe ti pergjigjemi cdo pyetjeje qe ju mund te keni gjate pergatitjes se ketij dokumentacioni. Nje shembull i formularit te aplikimit per vize i plotesuar gjendet ne faqen tone te internetit, ne adresen e internetit <http://www.germany.iha-info.org/studyingermany>. Dokumentat e meposhtme duhet ti paraqitni personalisht ne ambasade:

- Tre formulare aplikimi per vize-gjuhe afatgjate te plotesuar dhe te firmosur nga aplikanti (keto formulare meren ne Ambasaden Gjermane, Shqiperi)
- 3 fotografi te vogla pashaporte me sfond te bardhe
- Pashaporta e vlefshme dhe dy fotokopje te faqes ku ndodhet fotografia e aplikantit
- Letra e pranimit nga Shkolla e Gjuhes Gjermane (ky dokument ju postohet nga German Humanitarian Assistance e.V. menjehere pasi te keni bere para-pagesen e pjesshme prej 2000€ te kursit te gjuhes Gjermane prane Bankes Amerikane te Shqiperise apo ne llogarine tone bankare ne Gjermani)
- Dokument i leshuar nga studenti ku thuhet qe pas perfundimit te kursit te gjuhes eshte i interesuar te ndjeke Studienkolleg dhe me pas Studimet Universitare (vetem per te interesuarit per te kryer studimet universitare ne Gjermani).
- Kerkese ku spjegohet arsyjeja e ndjekjes se kursit te gjuhes Gjermane ne Gjermani (vetem per aplikantet qe jane te interesuar te mesojne gjuhen Gjermane dhe qe nuk duan ose qe nuk jane te sigurte nese duan te studiojne me pas ne Gjermani)
- Prove per mundesi financiare per te mbuluar shpenzimet e kursit te gjuhes dhe shpenzimet e jeteses gjate periudhes se kursit te gjuhes ne Gjermani. (Nje konfirmim bankar qe tregon qe ju ose prindet tuaj kane 6,000 EURO ne llogarine bankare. Nese konfirmimi bankar eshte ne emer te prinderve, atehere ky dokument duhet shoqeruar me nje leter nga prindi ku thuhet se kjo shume vihet te dispozicion te femijes per qellim studimi gjuhe.)
- Nje certifikate lindjeje e perkthyer ne gjuhen Gjermane, e noterizuar dhe nje fotokopje e saj (pas noterizimit).
- Diploma e shkolles se mesme, e konfirmuar si origjinale nga Seksioni i Aresimit ne qytetin tuaj, nga Ministria e Aresimit dhe Shkences se Shqiperise, nga Ministria e Jashtme e Shqiperise; duhet perkthyer ne gjuhen gjermane dhe noterizuar nga nje noter

i njohur nga Ambasada gjermane ne Shqiperi dhe e legalizuar ne ambasade (lista e notereve eshte e afishuar tek dera e hyrjes per ne ambasaden Gjermane). Ky dokument nuk nevojitet per aplikantet qe duan te ndjekin nje kurs te gjuhes Gjermane ne Gjermani por vetem per ato qe jane te sigurte qe deshirojne te studjojne ne Gjermani ne perfundim te kursit pergatitor te Gjermanishtes.

- Vertetimet qe provojne njohurite tuaja paraprake te gjuhes Gjermane (ne gjuhen Gjermane). Keto dokumenta nevojiten vetem per aplikantet qe duan te studjojne ne nje universitet Gjerman pas perfundimit te kursit parapergatitor per Studienkoleg/Universitet. Aplikantet duhet te provojne qe zoterojne njohuri te gjuhes Gjermane ekuivalente me 400 ore mesimore (45 minuteshe) Gjermanisht.
- Pagesa e vizes 25 EURO (te konvertuar ne lek shqiptar)

Seksioni i vizave e pranon aplikimin tuaj vetem nese i tere dokumentacioni i kerkuar eshte i rregullt dhe i plote. Nese dokumentat qe ju do dorezoni ne ambasade nuk jane te plota apo nuk jane pergatitur sipas kerkeses se kesaj ambasade, atehere asnje dokument nuk mbahet nga ambasada, prandaj ju lutemi ti filloni procedurat e aplikimit sa me heret te jete e mundur ne menyre te qe shmangni cdo vonese te mundshme. Ambasada e dergon dokumentacionin tuaj te aplikimit per vize prane Zyres se te Huajve ne Gjermani, viza jepet pasi ju plotesoni kriteret e sipershenuara. Nese ju keni proces gjygesor te hapur apo ndjekje penale ne Shqiperi, atehere vendimi per mos-dhenien e vizes se gjuhes meret nga ambasada Gjermane ne Tirane.

Ambasada Gjermane, Tirane Shqiperi

Aplikimet per vize: E hene – E premte, ora 8.00 – 12.00

Adresa: Rruga Skenderbeg 8 “Rruga e Ambasadave”, Tirane Albania
Telefon: 04-274-505
Telefon/Fax: 04-232-050 ose 04-233-497

Qyteti ku do pervetesoni gjuhen Gjermane

Momentalisht kurset parapergatitore te gjuhes Gjermane organizohen ne qytetin Jena – Gjermani. Me pas studimet e metejshe ju do i kryeni ne universitetin/qytetin qe ju do zgjidhni. Jena ndodhet ne krahinen e Thuringia e cila ndryshe quhet „Zemra e Gjelbert e Gjermanise“, e rrethuar me natyre te mrekullueshme. Jena eshte e famshme per traditat e saj kulturore filozofike, industrine e larte dhe mbi te gjitha Universitetin modern “Friedrich Schiller Universität” (FSU). Njihet si qytet “studentor” me rreth 100 000 banore dhe me nje tradite akademike qindra vjecare.

Ne fund te shekullit XIX dhe fillim te shekullit XX, Jena u shnderrua ne nje qender te shkences, teknologjise dhe industrise prej Carl Zeis dhe Ernst Abbe, te cilet kontribuan ne zbulimin e mikroskopit dhe perfeksionimin e pajisjeve optike. Kjo eshte arsyeja pse tashme Jena quhet ndryshe Jena-Zeis ku ndodhet nje nder planetaret me te vjeter ne bote.



Me teper informacion mbi studentet aktuale, mundesite me te fundit, foto etj gjenden ne faqen tone te internetit <http://germany.iha-info.org>

Ku do banoj une?

German Humanitarian Assistance e.V. do ju ndihmoje qe te gjeni akomodimin me te pershtatshem dhe me kosto sa me te ulet per koheqendrim nje muaj deri ne perfundim te studimit tuaj. Nese akomodimi qe GHA e.V. ka gjetur per ju nuk i permbush kerkesat tuaja, jeni te lutur qe gjate muajit te pare te akomodimit tuaj te kerkoni vete nje akomodim tjeter te pershtatshem per ju.

a) Apartamentet e nen-kontraktuara nga GHA e.V.

German Humanitarian Assistance e.V. ka nen-kontraktuar nje numer te caktuar apartamentesh me kater dhoma secili qe kushtojne si me poshte:

Pagesa per nje dhome: 150€ deri 190€ ne muaj.

Pagesa per person ne nje dhome per 2 persona: 134€ ne muaj

Ne kosto perfshihet mobilim i plote, kuzhine e pajisur e perbashket, bodrum i perbashket, energjia elektrike, ngrohja, uji, pastrimi i pallatit dhe pagesa e pleherave. Shpenzimi mbi normen e para-planifikuar i ujit, ngrohjes dhe energjise elektrike, eshte nen pergjegjesine tuaj.

Momentalisht ne disponojme vetem nje numer te caktuar apartamentesh me kete kosto prandaj jo te tere aplikantet mund te akomodohen aty.

b) Apartamente / garzoniere qe mund te merren me qera

- Cmimi per garzonier per 1 person (siperfaqja totale eshte 24 m²): 290€ ne muaj
- Cmimi per garzonier per 2 persona (siperfaqja totale eshte 24 m²): 320€ ne muaj (160€ per person ne muaj)

Per cdo apartament paguhet gjithashtu 220€ (vetem nje here) per kompanine qe ju ofron kete akomodim.

Apartamentet jane te rinovuara plotesisht dhe te mobiluara, madje ju nderrohen cercafet cdo dy jave. Apartamenti perfshin nje kuzhine te vogel, nje koridor, banjo, dhe nje ballkon. Ne cmim perfshihet gjithashtu shpenzimi i energjise elektrike, ngrohjes, ujit, pastrimit te pallatit dhe pleherat. Pagesa behet ne fillim te cdo muaji. Kontrata mund te anulohet duke derguar nje kerkese me shkrim te pakten nje muaj para dates se deshruar per te nderruar akomodim. Meqenese numri i ketyre apartamenteve eshte i kufizuar, ju rekomandojme te na konfirmoni sa me heret te jete e mundur akomodimin tuaj.

c) Akomodim ne Maxx Hotel

Nje mundesi tjeter akomodimi eshte Maxx Hotel, i cili eshte hotel me kater yje. Hoteli eshte shume lluksoz.

- Cmimi per person per nje dhome personale normale: 350€ ne muaj
- Cmimi per person ne nje dhome personale te vogel: 280€ ne muaj
- Cmimi per person ne nje dhome me dy persona: 225€ ne muaj

Ne cmimet e siperpermendura perfshihet bileta mujore e tramvajeve/autobuzave per udhetime te pakufizuara brenga qytetit. Gjithashtu ne cmim perfshihet perdorimi i pakufizuar i saunave, kopshtit Japonez dhe studios se fitnesit te hotelit. Dhomat jane shume lluksoze. Ne to perfshihet televizori dhe mundesia e perdorimit te internetit i cili nuk perfshihet ne koston e sipershenuar. Pastrimi i dhomes dhe nderrimi i cercafeve behet nje here ne dy jave. Ky akomodim perfshin nje koridor, banjo, dhe nje ballkon te vogel. Ju mund te zgjidhni nese deshironi te akomodoheni ne ambjente ku lejohet apo jo pirja e duhanit. Ne cmim perfshihet gjithashtu shpenzimi i energjise elektrike, ngrohjes, ujit te cilat jane te pakufizuara. Pagesa behet ne fillim te cdo muaji. Kontrata mund te anulohet te pakten 7 dite para dates se deshiruar per te nderruar akomodim. Meqenese numri i ketyre apartamenteve eshte i kufizuar, ju rekomandojme te na konfirmoni sa me heret te jete e mundur akomodimin tuaj.

Hoteli ka vendndodhje shume te favorshme, ai ndodhet shume afer stacionit te tramvajit dhe akomodimit a) te siperpermendur dhe vetem 9 minuta larg nga shkolla (me tramvaj).

Studentet qe nuk deshirojne ta sigurojne banimin e tyre nepermjet German Humanitarian Assistance e.V., mund ta zgjedhin vete apartamentin e banimit apo te banojne tek te afermit.

A do e perfitoni kursin qe ju nevojitet?

German Humanitarian Assistance e.V. do ju ndihmoje jo vetem qe ti pergjigjeni cdo lloj pyetjeje qe mund te keni, por do kujdeset qe te lehtesoje veshtiresite fillestare te te interesuarve per te studjuar me gjate ne Gjermani, duke ju siguruar Kursin Parapergatitor per Studienkolleg apo Universitet. Programi i kurseve qe ne ofrojme pergatitet per cdo individ duke patur parasysh nevojat e secilit aplikant. Cdo pjesemarres i programit "Asnje femije i lene pas dore" perfiton nga instituti gjuhesor IIK program individual deri ne momentin e pervetesimit te gjuhes Gjermane.

Ne perfundim te kursit te gjuhes, aplikantet qe kane mbaruar shkollen e mesme te pergjithshme, e qe duan te ndjekin Studienkolleg, pervec testimit mbi pervetesimin e gjuhes Gjermane, testohen nga pjesa me e madhe e universiteteve Gjermane edhe mbi terminologjine dhe aplikimin e matematikes. Per kete arsye, ne kursin parapergatitor per Studienkolleg/Universitet per studentet qe duan te studjojne shkenca ekzakte, perfshihet edhe marja e njohurive baze te terminologjise se matematikes.

Studentet shqiptare qe kane kryer 1 vit te studimit universitar ne nje universitet te Shqiperise, do trainohen dhe testohen per provimin DSH i cili i kualifikon per studim ne nje universitet Gjerman ne te njejten dege qe kane studiuar ne Shqiperi. Nese ato do deshirojne qe ne Gjermani te studiojne dege tjeter, duhet te kryejne provimin e Hyrjes ne Studienkolleg e me pas Studienkolleg/Universitet.

A duhet te keni njohuri paraprake te gjuhes Gjermane?


- ◆ Te interesuarve qe duan te studiojne me tej ne Gjermani pas perfundimit te kursit pergatitor per Studienkolleg i sugjerohet te kene kryer ne Shqiperi rreth 400 ore akademike te gjuhes Gjermane para ardhjes ne Gjermani. Pranohen gjithashtu Certifikata qe deshmon qe ju keni kaluar me sukses nje provim te njohur nga shteti Gjerman, i cili eshte ekuivalent me rreth 400 ore mesimore te gjuhes Gjermane.
- ◆ Te interesuarit qe kane kryer 1 vit te studimit universitar ne Shqiperi dhe qe deshirojne te studiojne ne Gjermani rekomandohen gjithashtu te kene njohuri paraprake te gjuhes Gjermane pasi provimi i DSH ka nivel veshtiresie me te madhe se ai i pranimit ne Studienkolleg/Universitet.
- ◆ Te interesuarit per te kryer nje kurs te gjuhes Gjermane ne Gjermani, pa qellim per te studiuar me tej, nuk nevojitet qe te kene njohuri paraprake te gjuhes Gjermane.

Para fillimit te kursit te gjuhes Gjermane apo kursit parapergatitor per Studienkolleg/Universitet, te tere aplikantet testohen mbi njohurite e Gjermanishtes qe zoterojne. Rezultati i ketij testimi i sherben institutit te gjuhes IIK dhe GHA e.V. per t'ju rekomanduar mbi numrin e oreve akademike te gjuhes Gjermane qe ju nevojiten ne menyre qe te pergatiteni per te kaluar me sukses provimin e hyrjes ne Studienkolleg/Universitet.

Si rregull, cdo aplikant qe deshiron te studioje gjuhen Gjermane ne Gjermani dhe te pajiset me vize-gjuhe, duhet te kryeje te pakten 20 ore akademike/jave (80 ore akademike/muaj).

Sic eshte permendur me lart, gjate kursit parapergatitor per Studienkolleg/Universitet, pervec mesimit te gjuhes Gjermane do ndiqet edhe nje numer i caktuar oresh mesimore mbi terminologjine dhe aplikimin e matematikes. Shembuj testesh te provimit te Studienkolleg/Universitet te dhena gjate viteve te kaluara nga universitete te ndryshem, zgjidhen gjate kursit parapergatitor per Studienkolleg/Universitet dhe te tera llojet e ndryshme te ushtrimeve shpjegohen ne klase.

Koha e fillimit te kursit parapergatitor per Studienkolleg/Unniversitet ne Gjermani dhe kohezgatja e tij varet nga njohurite paraprake te gjuhes Gjermane qe kane te interesuarit, prandaj per informacion me specifik ju lutemi te konsultoheni me perfaqesuesit e GHA e.V. ne Gjermani apo te IHA ne Shqiperi. Testimi qe specifikon nivelin e njohurive te gjuhes Gjermane qe cdo aplikant ka, do te kryhet ne zyren e programit ne Durres – Shqiperi. Per datat e provimit mund t'ju informojne me saktesisht perfaqesuesit e programit ne Shqiperi apo Gjermani. Ne raste te vecanta, mund te caktohet nje date provimi jashte datave te planifikuara. Disa kandidate mund te lejohen ta kryejne testimin-klasifikues ne Jena-Gjermani para fillimit te kursit parapergatitor.



- **Maksimumi** i kohezgjatjes se kursit parapergatitor per Studienkolleg/Universitet eshte 12 muaj. GHA e.V. / IIK ofron parapergatitje per Studienkolleg/Universitet per nje maksimum prej 10 muajsh.

- **Minimumi** i kohezgjatjes se kursit parapergatitor per Studienkolleg/Universitet eshte 4 muaj.

German Humanitarian Assistance e.V. i sugjeron te tere aplikanteve Shqiptare qe deshirojne te studiojne ne Gjermani qe te kene sa me shume njohuri te gjuhes Gjermane para aplikimit prane GHA e.V. Nje parapergatitje intensive ne Shqiperi ju kursen ju shpenzimin e mesimit te Gjermanishtes dhe te jeteses ne Jena – Gjermani, kohe si edhe ju jep me teper shence per te kaluar me sukses provimin e pranimit ne Studienkolleg/Universitet.

A do aprovoheni ne universitet dhe si?

Sic u permend edhe me siper, studimi ne universitetet Gjermane behet ne gjuhen Gjermane, prandaj njohja e gjuhes Gjermane eshte kerkese e detyrueshme. Pas perfundimit te Kursit Parapergatitor te Gjuhes gjate te cilit ju do te njiheni edhe me terminologjine baze te lendeve universitare si matematike etj., ju duhet testoheni per njohurite e Gjermanish. Marja me sukses e ketij testimi, ju lejon te studioni ne Studienkollegun/Universitetin perkates ku ju keni mare provimin.

Ne Studienkolleg ju do te trainoheni **Pa Pagese** mbi lendet specifike te deges universitare qe ju do zgjidhni ne menyre qe ta keni te lehte studimin universitar ne gjuhen Gjermane. Cdo universitet ka Studienkolleg e tij, por ne perfundim te Studienkolleg dhe madje edhe ne perfundim te vitit te pare te Universitet/Fachhochschule ju mund te transferoheni ne nje universitet tjeter. Ne perfundim te Studienkolleg ju do te perfitoni nje Kualifikim cili eshte ekuivalent me Diplomen e Shkolles se Mesme Profesionale Gjermane (per degen qe ju do studioni ne Universitet).

German Humanitarian Assistance e.V. vepron nen ligjet dhe rregullat e shtetit Gjerman. Ajo ka bere te tera marveshjet e tjera ligjore te nevojshme dhe si pasoje merr persiper ligjerisht te mundsoje qe studentet Shqiptare te studojne ne Gjermani ne cdo dege, ne cdo universitet, per cdo nivel kualifikimi.

Me teper informacion mbi studentet aktuale, mundesite me te fundit, foto etj gjenden ne faqen tone te internetit <http://germany.iha-info.org>

Informacion mbi kursin parapergatitor per Universitet prane Studienkolleg:

Kursi parapergatitor per studime universitare nga Studienkolleg zgjat dy semestre akademike dhe perfshin lendet e meposhtme:

Kursi parapergatitor per Universitet	Kursi parapergatitor per Fachhochschule
Kursi “TI” ju pergatit per te ndjekur universitetet e inxhinierise. Perfshin Gjermanisht, Matematike, Shkenca, Vizatim Teknik ose Shkenca kompiuterike.	Kursi “T” ju pergatit per te ndjekur universitetet e inxhinierise, matematikes dhe degeve te teyra shkencore. Perfshin Gjermanisht, Matematike, Fizike, Kimi, Shkenca kompiuterike.
Kursi “WW” ju pergatit per te studiuar per manaxhim dhe biznes. Perfshin Gjermanisht, Matematike, Ekonomi dhe Administrim Biznesi, teknologji informative dhe shkenca kompiuterike.	Kursi “M” ju pergatit per te studiuar per mjeksi dhe biologji. Perfshin Gjermanisht, Biologji, Kimi, Fizike, Matematike.
Kursi “GD” ju pregatit per te studiuar per arte dhe dizenjim. Perfshin Gjermanisht, Matematike, Dizenjim kreativ, Fizike, CAD.	Kursi “W” ju pergatit per te studiuar per ekonomi dhe dege te lidhura me shkencat sociale. Perfshin Gjermanisht, Matematike, Shkenca Kompiuterike, Ekonomi ose Anglisht, histori/gjeografi/studime sociale.
Kursi “SW” ju pergatit per te studiuar per shkenca sociale. Perfshin Gjermanisht, Matematike, Shkenca Sociale, Teknologji informative dhe Shkenca Kompiuterike, Anglisht.	Kursi “G” ju pregatit per te studiuar per arte, dege humanitare, shkenca sociale, dege artistike, gjuhe Gjermane dhe letersi. Perfshin Gjermanisht, Histori, Literature Gjermane ose Anglisht, Shkenca Sociale/Gjeografi.
Kursi “DU” ju pergatit si perkthyes / interpreter. Perfshin Gjermanisht, dy gjuhe te huaja (Anglisht apo Frengjisht), nje gjuhe te trete (Spanjisht etj), Teknologji informative dhe Shkenca kompiuterike.	Kursi “S” ju pergatit per gjuhesi (duke perjashtuar gjuhen Gjermane). Perfshin Gjermanisht, Histori, dy gjuhe te huaja, nje gjuhe te trete ose studime sociale/gjeografi ose literature Gjermane.
Gjithashtu ne kete kurs perfshihet instruktimi mbi degen per te cilen ju jeni te interesuar te kryeni studimin universitar.	Gjithashtu ne kete kurs perfshihet instruktimi mbi degen per te cilen ju jeni te interesuar te kryeni studimin universitar.

Qe te lejohen te aplikojne prane Studienkolleg, te tere studentet duhet te deshmojne njohuri te mjaftueshme te gjuhes Gjermane nepermjet testimeve qe deshmojne nivelin e kerkuar nga universitetet perkatese apo nepermjek ndjekjes se numrit te kerkuar te oreve mesimore te gjuhes Gjermane ne Gjermani.

Tipet e universiteteve ne Gjermani

Ne Gjermani ndodhen 349 institucione te arsimit te larte te lokalizuara ne qytete te ndryshme. Ju qe jeni te interesuar te studioni ne Gjermani mund te zgjidhni ndermjet universiteteve dhe institutive me status universitar sic jane Universitetet teknike ose Institutet e ashtuquajtur "Fachhochschule", ose kolegjet e artit, muzikes dhe filmit.

Vendimi se ne cilin tip universiteti deshironi te studioni varet shume nga deget qe ju deshironi te studioni. Para se te aplikoni per nje universitet ju duhet te jeni te qarte mbi prirjet tuaja dhe mbi deget qe ju pelqen te studioni ne menyre qe te aplikoni ne universitetin me te pershtatshem per ju. German Humanitarian Assistance e.V. mer persiper t'ju ofroje konsulence **pa pagese** per zgjedhjen e universitetin dhe degen qe permbush kerkesat tuaja.

- ✓ Nese jeni te prirur te studioni me teper dege dhe lende praktike dhe ju intereson ta perfundoni studimin universitar ne nje kohe sa me te shkurter - ju rekomandojme te aplikoni prane „Fachhochschule“.
- ✓ Nese jeni te prirur drejt shkences dhe teorise - ju rekomandojme te aplikoni prane „Universitaet“.

Ne Gjermani ju mund te kryeni te tere studimin universitar apo studime te pjesshme (per shembull nje vit) por pa u kualifikuar. Nese jeni diplomuar ne Shqiperi ju mund te ndiqni studimet pasuniversitare ne Gjermani (Master, Doktorature, Post-Dok. Etj.).

◆ Permbledhje informative mbi studimin universitar ne Gjermani

Universitetet Gjermane nuk jane vetem institucione qe ofrojne trainim dhe edukim por jane vendi ku ne menyre te pavarur kryhen studime te ndryshme shkencore. Ne perfundim te universitetit ju mund te merni kualifikime akademike te ndryshme te njohura ne mbare boten sic jane:

- a. **Diplome universitare** per degen qe ju do zgjidhni (dega zgjidhet pa konkurim)
- b. **Master** per profiling qe ju intereson (mund te kryhet ne gjuhen Gjermane apo Angleze)
- c. **Doktorature** ne temen qe ju pelqen (ne gjuhen Gjermane apo Angleze)
- d. **Profesor Universiteti:** Universitetet Gjermane kane te drejten te trainojne dhe kualifikojne Profesoret e Universiteteve.
- e. **Specialist ne dege te ndryshme:** Per deget e ndryshme te fakulteteve dhe shkollave ofrohet mundesia e specializimit pasuniversitar ne perfundim te te cilit ju beheni Specialist i Avancuar per nje fushe brenda nje shkence te caktuar.

Fakultetet dhe shkollat universitare ju ofrojne nje spekter te gjere degesh studimi si per shembull mjeksi, shkenca, inxhinieri, arte e dege humanitare, ligj, teologji, ekonomi, shkenca sociale, agriculture, studime mbi pyjet etj. Megjithese studimet universitare bazohen ne nje sere ligjesh dhe rregullash, shumica e fushave te studimit ju japin studenteve mundesine e zhvillimit te **punes shkencore** individuale dhe te pavarur.

◆ **Universitetet Teknike**

Ashtu sic e thote edhe emri, universitetet teknike e fokusojne punen e tyre ne deget teknike dhe inxhinierike. Megjithate keto universitete vazhdojne ta zgjerojne spektrin e degeve qe perfshijne. Tashme ka shume universitete te ashtuquajtura teknike, ku studentet mund te studjojne per dege humanitare, arte etj.

◆ **Fachhochschule**

Numri i studenteve qe ndjekin studimin e larte universitar prane institucioneve "Fachhochschule" po rritet gjithnje e me teper. Nje nga arsyeset eshte sepse kohezgjatja e studimit prane "Fachhochschule" eshte me e shkurter dhe sepse ky lloj studimi orjentohet me teper drejt praktikës sesa drejt kerkimeve shkencore dhe teorise. Termi "Fachhochschule" shpesh perkthehet si "Universiteti I Shkencave te Aplikuara".

◆ **Kolegjet e Artit dhe Muzikes**

Kolegjet e Artit dhe Muzikes ne Gjermani pergatisin artiste dhe muzikante si edhe mesues ne fusha te ndryshme te Artit.

◆ **Institucionet e tjera me status universitar**

Ne Gjermani ndodhen gjithashtu kolegje ku mesuesit studjojne per te dhene mesim ne shkollat fillore, shkollat e mesme te nivelit te ulet, shkollat e specializuara dhe ne disa raste shkolla te mesme te pergjithshme.

Po keshtu ju mund te studioni edhe ne nje numer te institucioneve te arsimit te larte te cilat fokusohen ne dege shume specifike sic eshte Shkolla e Larte e Veterinarise, Shkolla e Larte Sportive, Shkolla e Larte Kinematografike etj.

Cfare kosto do kete studimi im?

Gjate periudhes se pervetesimit te gjuhes Gjermane dhe aplikimit per studim te metejshem, studentet do shpenzojne kryesisht per Kursin e Gjuhes Gjermane, akomodimin, ushqimin, sigurimet shendetesore, veshje dhe nevoja personale. Per te mbuluar keto shpenzime ne ju rekomandojme te planifikoni rreth 800€/muaj per kohezgjatjen e pervetesimit te gjuhes.

◆ **Sigurimet Shendetesore:** Cdo student duhet te paguaje Sigurime Shendetesore ne menyre qe te lejohet te studioje dhe jetoje ne Gjermani. Kjo do te thote qe kur t'ju duhet te vizitoheni apo kuroheni tek cdo mjek, dentist, mjeku i syve ose ne spital tek specialisti, shpenzimet do ju rimburohen nga kompania prane te ciles paguani sigurimet shendetesore. German Humanitarian Assistance e.V. do ju ndihmoje te lidhni kontrate me kompanine me te pershtatshme per ju.

◆ **Ndihme financiare:** Per te ndjekur kursin parapergatitor te gjuhes Gjermane, studenteve nuk u mundesohet ndihme financiare. German Humanitarian Assistance e.V. do

mundohet te siguroje fonde per te mbuluar pjeserisht keto shpenzime, por kjo nuk eshte akoma e sigurte.

- ◆ **Mundesite e punesimit:** Gjate periudhes se pervetesimit te gjuhes Gjermane ju nuk mund te punesoheni. Por, pasi te kaloni me sukses provimin e hyrjes ne Studienkolleg/Universitet ju do mund te punesoheni 90 dite ne vit. Ne Gjermani, pothuajse te tere studentet qofshin vendas apo te huaj punojne dhe i mbulojne vete shpenzimet e jeteses, nderkohe qe shpenzime per studimin universitar nuk do kene pasi universiteti ne Gjermani eshte pa pagese.

Si dhe kur do paguaj une per kursin pergatitor ne Jena-Gjermani?

Studentet Shqiptare jane te perjashtuar per te paguar “Koston e Aplikimit” prane German Humanitarian Assistance e.V. Ajo qe ju jeni te detyruar te paguani eshte “Kosto Programit”. Shpenzimet e tjera qe ju mund te keni jane gjithashtu nen pergjegjesine tuaj.

Te tere te interesuarit per te ndjekur nje kurs parapergatitor, duhet te paguajne paraprakisht si garanci shumen prej 2000€. Kjo para-pagese perdoret per kursin parapergatitor qe do ndiqni ne Jena-Gjermani dhe eshte ekuivalente me 400 ore mesimore te gjuhes Gjermane (5€ per 1 ore akademike). Perjashtim nga ky detyrim bejne vetem aplikantet per kurse te shkurtra 3-4 javore apo shkolle verore.

Nese ju do ju nevojiten dhe do konfirmoni qe ne Gjermani do kryeni me teper se 400 ore mesimore te parapaguara, atehere diferenca e pageses, i behet GHA e.V. brenda dy javeve pas mberritjes suaj ne Gjermani. Nese do ju nevojiten me pak se 400 ore mesimore, atehere GHA e.V. do jua ktheje diferencon e parave pasi ju te keni mberritur ne Gjermani.

Pagesa juaj perfshin tere shpenzimet e programit. Pasi ju te keni marre Aprovimin Perfundimtar dhe vendosni te anuloni studimin tuaj, para-pagesa nuk eshte e rikthyeshme. Parapagesa prej 2000€ rikthehet ne rast se viza juaj refuzohet, ne kete rast disa shpenzime te vogla te bera nga GHA e.V. nuk rikthehen.

Bank name: Banka Amerikane e Shqiperise	Name of the bank: Deutsche Kreditbank AG
Account holder: Int'l Humanitarian Assistance	Kontoinhaber: German Humanitarian Assistance e.V
Account number: 10135	Kontonummer: 110 159 14
Account name: Studime ne Gjermani	BLZ: 120 300 00
	IBAN: DE66 1203 0000 0011 0159 14
	BIC (SWIFT): BYLADEM1001

Nese pagesa paraprake behet prane Deutsche Kreditbank AG ne Gjermani, shpenzimet e transfertes jane ne pergjegjesine tuaj.

Ju nuk duhet te paguani per tere librat, broshurat dhe materjalet e fotokopjuara apo te printuara gjate kursit te gjuhes Gjermane, perdorimin e kompiuterave te institutit te gjuhes, provimet e Zertifikat Deutsch dhe Mittelstufe, tere sherbimet e shenuara ne paketen e sherbimeve te ofruara nga GHA e.V.

Permbledhje e Sherbimeve te Ofruara

◆ Para mberritjes suaj ne Gjermani GHA e.V. dhe IHA do ju ofroje sherbimet e meposhtme:

- Venie ne dispozicion e listes se dokumentave te kerkuara per vizen e gjuhes gjermane dhe asistence per plotesimin e sakte te ketyre dokumentave.
- Venie ne dispozicion e formularit te aplikimit per vize-gjuhe te plotesuar.
- Informim individual dhe pergjigje per cdo pyetje qe mund te keni.
- Venie ne dispozicion e Broshures Informative me informacion mbi procedurat qe duhet te ndiqen deri ne momentin e regjistrimit tuaj ne universitet.
- Postim i nje dokumenti informativ me listen e dokumentave qe duhet te keni me vete ne Gjermani, informim i detajuar mbi jetesen ne Gjermani, keshillime mbi cfare duhet te parapergatitni para mberritjes ne Gjermani.

◆ Pas mberritjes suaj ne Gjermani GHA e.V. do ju ofroje sherbimet e meposhtme :

- Shoqerim per ne akomodimin tuaj
- Dhurate mirseardhjeje qe GHA e.V. e ka pergatitur per ju.
- Informim mbi te drejtat dhe pergjegjesite tuaja gjate banimit tuaj ne konvikt / apartament.
- Informim per gjetjen e apartamentit tuaj nese vendbanimi i gjetur nga ne nuk i permbush kerkesat tuaja.
- Informim mbi ligjin Gjerman per te huajt.
- Informim mbi sistemin e arsimimit ne Gjermani, universitetet dhe deget perkatese dhe ndihme ne zgjedhjen e Universitetit qe ju intereson.
- Informacion rreth cmimeve dhe mundesive per te perfituar sherbime me kosto me te ulet.
- Asistence ne kryerjen e te formaliteve burokratike per regjistrimin tuaj si banor ne Jena.
- Asistence ne plotesimin e tere dokumentacionit te kerkuar dhe shoqerim ne te tera zyrat perkatese ne rast se nevojitet.
- Perkttime te dokumentave tuaja ne gjuhen Gjermane psh. certifikatat e trainimeve, diplomat, certificate lindjeje etj. (I panoterizuar).
- Pergjigje mbi pyetjet qe mund te keni gjate qendrimit tuaj ne Jena-Gjermani.
- Ndhime ne gjetjen e kompanise se sigurimeve shendetesore te pershtatshme per ju dhe asistence ne plotesimin e dokumentacionit te kerkuar per mareveshjen tuaj per sigurimet shendetesore te cilat jane te detyrueshme.
- Asistence ne hapjen e llogarise suaj bankare dhe sigurimin e kartes bankare ne Jena-Gjermani. Mbajtja e llogarise dhe karta bankare do ju sigurohen pa pagese.
- Kurs i gjuhes Gjermane dhe nese nevojitet edhe i matematikes. Kurset do ju pergatitin per qellimin specifik per te cilin ju vini ne Gjermani (parapergatitje per studime te metejshme ne Gjermani apo thjesht mesim i gjuhes Gjermane).
- Organizim i disa aktiviteve creative te kohes se lire me kosto te ulet gjate qendrimit ne Jena-Gjermani (sipas deshires).
- Keshillim lidhur me karrieren tuaj akademike ne Gjermani
- Keshillim per zgjedhjen e deges suaj te studimit
- Keshillim ne zgjedhjen e universitetit me te pershtatshem per degen e ju pelqen
- Venie ne dispozicion e listes se dokumentave te kerkuara per aplikim nga cdo universitet ku ju jeni i interesuar te aplikoni.

- Venie ne dispozicion e formulareve te aplikimit prane cdo universiteti qe ju do zgjidhni.
- Asistence ne plotesimin e dokumentave te aplikimit dhe dokumentave te tjera qe i bashkangjiten aplikimeve tuaja ne universitetet qe keni zgjedhur qe te aplikoni.
- Dergim i dokumentave tuaja te aplikimit prane universiteteve te zgjedhura nga ju duke ndjekur afatet e ndryshme te aplikimit te vendosura nga cdo universitet.
- Komunikim direkt me universitetet perkatese per te sqaruar ndonje problem te mundshem qe sjell refuzimin e aplikimit tuaj.
- Qenie ne dispozicion te universiteteve ku pjesemarrjesit e programit “Asnje femije i lene pas dore” kane aplikuar per te sqaruar cdo pyetje mbi dokumenta qe mungojne apo qe nuk jane plotesuar saktesisht.

Adresa e kontaktit

Per cdo pyetje, paqartesi apo informacion qe mund t’ju nevojitet, ju lutemi te kontaktoni nje nga perfaqesues te “Programit te studimit te larte per Shqiperine” ne Shqipeir apo Gjermani.

SHQIPERI

Zj. Ermira Rexha

Perfaqesuese per Vendin, Shqiperi
International Humanitarian Assistance (IHA)

Adresa: L.5, Rr. “Deshmoret”, Nr. 102
Durres, Shqiperi

Tel./Fax: 052 - 34909
Tel.: 052 - 24610
Cel.: 069 – 273 - 4810
E-mail: germany@iha-info.org

Zj. Myzejen Agolli

Anetare vullnetare, Shqiperi

Tel.: 052-20466
Cel. 068-22-75-280

Zj. Denisa Celcima

Anetare vullnetare, Punonjese sociale

Cel.: 068-293-3249
Tel.: 052-25319

GJERMANI

Z. Gennadi Rabinovitch

German Humanitarian Assistance e.V.
Perfaqesues per Vendin, Gjermani

Adresa: Anna-Siemsen-Str.18, 07745
Jena, Germany

E-mail: gennadi@iha-info.org
Tel./Fax: +49-3641-232684
Celular: +49-179-217-6407
Fax: +49-3641-635324

Zj. Alba Fishta, MD, MPH

German Humanitarian Assistance e.V.
Drejtore Ekzekutive

Adresa: Anna-Siemsen-Str.18, 07745
Jena, Germany

E-mail: alba@iha-info.org
Tel./Fax: +49-3641-232684
Tel. +49-3641-680018
Celular: +49-179-799-7281



**hap porten e se ardhmes suaj
... ju duhet te futeni vete aty**

**PER MUNDESIMIN E KETIJ PROGRAMI KA KONTRIBUAR PERKUSHTIMI
VULLNETAR I PERFAQESUESVE NE SHQIPERI DHE GJERMANI.**

Me teper informacion mbi studentet aktuale, mundesite me te fundit, foto etj gjenden ne faqen tone te internetit <http://germany.iha-info.org> 18